



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE URBANE ELBASAN**

Elbasan, më 20/02/2026

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Furnizim vendosje sinjalistikë horizontale dhe materiale sugurie rrugore”.

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar-Marrëveshje kuader –mallra”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Vijëzime të rrugëve 34922100-7 ; Pajisje për kontrollin e trafikut rrugor 34923000-3 ; Bojra për rrugë 44811000-8

VLERA E FONDIT LIMIT - 2,497,915 (dymilionë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa T.V.SH.

Argumentimi : Bazuar në Nenin 76 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 1, me anë të shkresës 90/3 datë 19/02/2026, bazuar në të dhënat e “Sistemit të Integruar të Manualit të çmimeve në ndërtim” Nr. Analize 3.943 për zërin e parë të preventivit ndërse me anë të formës së studimit të tregut për zërin e dytë dhe të tretë të preventivit, komisioni i ngarkuar, ka bërë përlllogaritjen vlerës së prokurimit.

N baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c të dhenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimin Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % e fondit limit të prokuruar.

Kriteri (2.1) është vendosur referuar nenit 43 pika 1,2,3 dhe nenit 55 pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri (2.2) eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP si dhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

3. Kapaciteti teknik dhe profesional:

3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet te paraqese vertetimet e leshuara nga nje ent public ose fatura tatimore te shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara,

ose

Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje,te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi,dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të e mallrave të furnizuara.

Shënim : Për të dyja rastet operatori ekonomik krahas vërtetimeve apo faturave tatimore, duhet të paraqesë edhe vërtetim në formën e situacioneve përfundimtare ku duhet të përcaktohet saktësisht cilësia e kryerjes së shërbimeve dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë edhe :Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Kriteri 3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”si dhe bazuar ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me “Liçensë Profesionale për veprimtari Ndërtuese Zbatimi” të vlefshme për zbatimin e objektit të Kontratës, lëshuar nga Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Liçensave Profesionale për Shqëritë që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtuese Zbatimi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

-N.S – 6/A (SINJALISTIKA RRUGORE JONDRIÇUESE)

Kriteri 3.2 është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/a dhe neni 41, pika 4/a të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që disponojnë liçensa profesionale për prodhimin ose furnizimin e mallrave dhe realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; Bazuar në Vendimin Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.**

3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë :

- Një makineri për aplikimin e bojës Bikomponente, APV;
- Një makineri vijëzimi vetë-lëvizëse me bojë bikomponente;
- Një kamionçinë me kapacitet mbajtës jo më pak se 1.5 ton;
- Një kompresor i lëvizshëm;
- Një karrel për sinjalizimin e punimeve në rrugë jo më pak se 100 kg;
- Një gjenerator;
- Dy cope set semaforësh për kontrollin e trafikut;
- Një mjet për pastrimin e vijave/bojës ekzistuese;
- Një mjet transporti ATV – karrotrec me kapacitet mbajtës 2-2.5 ton.

Për të cilat duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtëm :

-Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; leje qarkullimi; çertifikata e kontrollit Teknik; siguracionin e mjetit (I vlefshëm), taksat vjetore si dhe lejen e transportit të mallrave brenda vendit për ato mjete që pajisen me leje transporti të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi.

-Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; leje qarkullimi; çertifikatën e kontrollit Teknik; siguracionin e mjetit I vlefshëm; lejen e transportit të mallrave Brenda vendit për ato mjete që pajisen me leje transporti të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë me objekt të përcaktuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

-Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.

-Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat noteriale të qerasë, faturat tatimore të shitjes / kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me TVSH (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me ane të Formularit Përmbledhes të Vetedeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili verteton disponimin e automjeteve dhe makinerive, dorezohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri 3.3 është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Makineritë për vijeimin do të pëdoren për procesin e vijeimit të rrugës. Kamionçina do të pëdoret për transportin e materialeve dhe punëtorisë. Kompresori shërben si pajisje ndihmëse gjatë vijeimit. Karreli shërben si pajisje sigurie gjatë punës. Gjeneratori shërben si pajisje ndihmëse gjatë proceseve të punës. Seti i semaforeve do të shërbejë si pajisje sigurie dhe orientuese gjatë punës. Mjeti për pastrimin e bojes do të shërbejë si makineri ndihmëse gjatë procesit të punës. Mjet ATV karrotrec do të shërbejë për transportin e makinerive mbeshetese.

3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë staf Teknik si më poshtë :

- Një inxhinier ndërtimi të diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi profili infrastrukturë transport;
- Një inxhinier mekanik me profil sinjalistikë dhe siguri rrugore;
- Dy manovratorë të pajisur me dëshmi kualifikimi si “Manovrator vijëzim asfalti”
- Dy punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi si “Saldator”;
- Shtatë punonjës ndihmës.
- Një punonjës i çertifikuar si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.
- Një punonjës i çertifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

Ky kriter do të permbushet nga OE me anë të Formularit Permbledhes të Vetedeklarimit. Dokumentacioni provues : diploma; kontratë pune të vlefshme dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore, për vërtetimin e kualifikimit dhe punësimit të punonjësve, dorezohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri 3.4 është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion burimet e nevojshme njerëzore të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Inxhinieri i ndërtimit i diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi profili** do të përcaktojë tipin e vijezimit si dhe do të Sigurojë perputhshmerinë me gjeometrinë e rruges dhe kategorinë e saj. Garantoni që vijezimi rrit sigurinë dhe qartësinë për drejtuesit. Inxhinieri Mekanik (Profil Sinjalistikë, Siguri Rrugore) do të përcaktojë parametrat teknike të materialeve reflektuese (dukshmeria natën, koeficienti i reflektimit). Siguron që vijezimi të jetë efektiv në kushte të ndryshme atmosferike. Kontrollon pajisjet e aplikimit (makineritë e vijezimit). **Dy manovratorë** të pajisur me dëshmi kualifikimi si “Manovrator vijëzim asfalti” do të përdorin makineritë për vijëzimin e asfaltit. **Dy punonjës** të pajisur me dëshmi kualifikimi si “Saldator” do të asistojnë për procesin e saldimit të konstruksioneve metalike gjatë montimit të postacioneve të biçikletave dhe birilave. Shtatë punonjës ndihmës do të përgatisin sipërfaqen e punës, do të shenojnë piketat, do të ofrojnë asistencë teknike, do të furnizojnë me materiale si dhe do të devijojnë qarkullimin e mjeteve.

3.5 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate nga administratori i shoqërisë **Drejtuesin Teknik (inxhinier ndërtimi me eksperiencë)**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që të kryhet shërbimi.

Ky kriter do të permbushet nga OE me anë të Formularit Permbledhes të Vetedeklarimit. Dokumentacioni provues : diploma; kontratë pune të vlefshme dhe

librezë pune dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kriteri 3.5 është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion burimet e nevojshme njerëzore të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Drjtuesi Teknik do të jetë i pranishëm gjatë gjithë proceseve te punes dhe do te kujdeset per mbarevajtjen e punes deri ne realizimin e objektit te kontrates.**

3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që ka lidhje me objektin e kontratës, leshuar nga institucionet zyrtare te akredituara per kete qellim, si më poshtë:

-SSH/ EN - ISO 9001:2015 në fushën e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

-SSH/ EN - ISO 14001:2015 në fushën e menaxhimit mjedisor ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

-SSH/ EN - ISO 45001:2018 në fushën e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

-SSH/ EN - ISO 39001:2012 në fushën e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

Kriteri 3.6 është vendosur në përputhje me Nenin 40 pika 6 gërma (c) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar ne nenin 79 te LPP.

Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik ofertues të jetë i pajisur me çertifikatën e menaxhimit të cilësisë gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë te AK që ky OE do të ofertojë produkte të çertifikuara të një cilësie të mirë, në përputhje me standartet ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga DPA.

3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit / distributorit të autorizuar ose kontratë furnizimi për mallrat **(bojë bikomponente spray, parkim biçikletash me 8 vende (postacione) dhe birila lavjerrës h = 823 mm)**. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si : telefon, fax, e-mail,website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në raste verifikimesh të mëtejshme. Në rast të disponimit të autorizimit të

prodhuesit / distributorit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer e i noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastet e paraqitjes së autorizimeve nga një distributor, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të Autorizuar.

Kriteri 3.7 është vendosur bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogë / fragmente të katalogëve të prodhuesit ose Skeda Teknike** për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilën të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen me logon e tij e ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.

Kriteri 3.8 bazohet në Nenin 40 pika 6, gërma (b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, janë vendosur për shkak të natyrës specifike të produkteve, për të dëshmuar autoritetit kontraktor se malli i ofruar plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportet e testimit të lëshuara nga organizma të njohur evropian / organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara, për bojën bikomponente spray.

Kriteri 3.9 bazohet në Nenin 40 pika 6, gërma (c) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, janë vendosur për shkak të natyrës specifike të produkteve, për të dëshmuar autoritetit kontraktor se malli i ofruar plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

3.10 Operatori Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duhet të paraqesë mostrat për elementet e mëposhtëm sipas preventivit dhe specifikimeve të kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit **5 Mars 2026, ora 12:00** në ambjentet e Agjencisë së Shërbimeve Publike Urbane, Bashkia Elbasan, Adresa: Lagje Visarion Xhuvani, Rruga e Re, Elbasan, konkretisht:

Nr	Emertimi i mallit	Njesia
1	Boje Bikomponente spray	Paketim 25 kg
2	Parkim biçikletash me 8 vende (postacione)	1 copë
3	Biril lavjerrës h=823mm	1 copë

Kriteri 3.10 bazohet në Nenin 40 pika 6, gërma (a) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, janë vendosur për shkak të natyrës specifike

të produkteve, për të dëshmuar autoritetin kontraktor se malli i ofruar plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT